



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0210

OSHP:2024/0233

OSHP:2024/0234

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e amendamentuar me datën 09. 08. 2023 në përbërjen nga, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “V.Z. Company” Sh.p.k. si dhe ankesës së OE “EL-Bau” SH.P.K, si dhe ankesës OE “AVAG Group SH.P.K.” kundër vendimit për dhënie te kontratës për procedurën e prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve debllokimi i kanalizimit atmosferik” për Lot 11 me nr. të prokurimit: "616-23-13231-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më 19. 06. 2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e “V.Z. Company” Sh.p.k me nr. 2024/0210 e datës 13.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve debllokimi i kanalizimit atmosferik” për Lot-2, me nr. të prokurimit: "616-23-13231-2-1-1" të Komunës së Prishtinës në cilësi të autoritetit kontraktues (AK), ndërkaq aktiviteti i prokurimit për LOT -2, kthehet në rivlerësim.

2. Aprovohet, si e bazuar ankesa e “EL-BAU” SH.P.K Sh.p.k me nr. 2024/0233 e datës 18.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve debllokimi i kanalizimit atmosferik” për Lot-3, me nr. të prokurimit: "616-23-13231-2-1-1" ndërkaq aktiviteti i prokurimit për Lot-3, kthehet në rivlerësim

3. Aprovohet, si e bazuar ankesa e “AVAG Group SH.P.K.” me nr. 2024/0234 e datës 18.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve debllokimi i kanalizimit atmosferik” për Lot-11 me nr. të prokurimit: "616-23-13231-2-1-1" ndërkaq aktiviteti i prokurimit për Lot-11, kthehet në rivlerësim.

4. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorve ekonomik; 2024/0210, 2024/0233 dhe 2024/0234 , sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.11.2023, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve deblokimi i kanalizimit atmosferik”.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: a. LOT 2 - 194,000€.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: b. Lot 3 - 194,000.00€.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: c. LOT 11-141,000€.

Me 23.02.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë: për Lot 2 është rekomanduar OE “Anuar”, për Lot 3 GOE “Via Egnatia SHPK & VJV Group L.L.C & Rahovica Commerce SHPK & Infrastruktura SHPK” si dhe është rekomanduar për Lot 11 GOE “Via Egnatia Sh.P.K. & VJV Group L.L.C.& Rahovica Commerce Sh.P.K. & Infrastruktura Sh.P.K. dega në Kosovë.

Me 27.02.2024, OE “V.Z. Company” Sh.p.k ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Anulim të cilën AK e ka refuzuar me datën 06. 03. 2024.

Me 28.02.2024, OE “El-Bau” Sh.p.k ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Anulim të cilën AK e ka refuzuar me datën 06. 03. 2024. Poashtu me të njëjtën datë kërkesë për rishqyrtim ka parashtruar edhe OE “AVAG Group SH.P.K.” e cila është refuzuar në të njëjtën datë nga AK.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së OE ankues “V.Z. Company” SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 2024/0210 e datës 13.03.2024, OE ankues “El- Bau” SH.P.K ka parashtruar ankesë me nr. 2024/0233 të datës 18.03.2024 si dhe OE ankues “AVAG Group SH.P.K” ka parashtruar ankesë me nr. 2024/0234 të datës 18.03.2024.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të tri ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 210/24, ankesa nr. 233/24 dhe 234/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

1. Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues në pretendimet e parashtruara në kërkesën për rishqyrtim

1.1 Përgjigja e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE "V.Z. Company" Sh.p.k

Pretendimet e OE "VZ Company" Sh.P.K. janë se nuk qëndrojnë arsyet sipas njoftimit mbi vendimin për Lot 2 lidhur me OE "VZ Company" ku thuhet se parashtruesit i mungojnë 2 makineri mbi 8 tonë. Lidhur me këto pretendime duhet cekur se në dosjen e tenderit për Lot 2 ndër të tjera është kërkuar që të ofrohen 4 kamionë me së paku 8 tonë peshë. Në anën tjetër parashtruesi ka ofertuar me vetëm 2 makineri me mbi 8 tonë ndërsa i mungojnë edhe 2 makineri të tjera të tilla. Në fakt edhe vet parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim nuk e mohon faktin se i mungojnë 4 makineri me mbi 8 tonë. Mirëpo në këtë rast pretendon se nuk janë të nevojshëm këto makineri respektivisht i konteston kërkesat e dosjes së tenderit. Sa i përket kundërshtimit të kërkesave në dosjen e tenderit, parashtruesi ka pasur mundësi që të parashtroj kërkesë për rishqyrtim para hapjes së ofertave kundër njoftimit për kontratë ndërsa në këtë fazë nuk mund të kontestohen kërkesat e DT.

1.2 Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit "El Bau" SH.P.K

Pretendimet e OE "E1 - Bau" Sh.P.K. janë se operatori ekonomik RSM Sh.P.K. dhe tenderuesi i rekomanduar për lot 3 "Via Egnatia" kanë dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Sa i përket pretendimeve ankimore të drejtuara kundër RSM duhet cekur se parashtruesi në raport me këto pretendime nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP pasi që RSM nuk është rekomanduar për Lot 3 mirëpo është rekomanduar një tenderues tjetër. Prandaj këto pretendime janë të pabazuara. Pretendimet e parashtruesit kundër tenderuesit të rekomanduar "Via Egnatia" janë se nuk ka dëshmuar makineritë e kërkuara, njëkohësisht është ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta si dhe një nga anëtarët ka lidhur marrëveshje me ATK për shlyerjen e borxhit. Sa i përket pretendimit lidhur me marrëveshjen e njërit prej anëtarëve të GOE "Rahovica Commerce" me ATK për shlyerjen e borxhit, duhet sqaruar se ky pretendim është i pabazuar për faktin se tenderuesi i rekomanduar për lot 3 si konzorcium i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit mbi gjendjen ekonomik dhe financiare (ky fakt nuk kontestohet fare as nga parashtruesi). Ndërsa sa i përket pjesës së marrëveshjes duhet sqaruar se marrëveshja është lidhur para datës së publikimit të njoftimit për kontratë (fakt që nuk kontestohet nga parashtruesi). Rrjedhimisht kjo marrëveshje është e lejuar sipas LPP dhe kjo konfirmohet ndër të tjera edhe përmes interpretimit të KRPP nr. 6 të datës 22.11.2022 ku ndër të tjera thuhet se "KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës". Sa i përket pjesës së pretendimeve lidhur çmimet jonormalisht të ulëta nuk janë përmbushur sipas nenit 41 par. 41.3 të RRPP ku përcaktohet "41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë". Sa i përket pjesës makinerive, sipas komisionit vlerësues është konfirmuar se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar të gjitha dëshmitë dokumentare për makineritë e kërkuara sipas dosjes së tenderit. Në anën tjetër as parashtruesi nuk ka argumentuar të kundërtën me dëshmi bindëse. Sa i përket pretendimeve tjera ankimore lidhur me plotësimin e listës së kontratave, sipas raportit të komisionit vlerësues dhe sipas ofertës së tenderuesit të rekomanduar është konfirmuar se lista është plotësuar dhe dorëzuar në përputhje të plotë me DT. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "El-Bau" Sh.P.K. janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

1.3. Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit "AVAG Group SH.P.K"

Pretendimet e OE "AVAG Group" Sh.P.K. janë se operatori ekonomik Alko Impex dhe tenderuesi i rekomanduar për lot 11 "Via Egnatia" kanë dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Sa i përket pretendimeve ankimore të drejtuara kundër Alko Impex duhet cekur se parashtruesi në raport me këto pretendime nuk

është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP pasi që Alko Impex nuk është rekomanduar për Lot 11 mirëpo është rekomanduar një tenderues tjetër. Prandaj këto pretendime janë të pabazuara. Pretendimet e parashtruesit kundër tenderuesit të rekomanduar "Via Egnatia" janë se nuk ka dëshmuar makineritë e kërkuara, njëkohësisht është ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta si dhe një nga anëtarët ka lidhur marrëveshje me ATK për shlyerjen e borxhit. Sa i përket pretendimit lidhur me marrëveshjen e njërit prej anëtarëve të GOE "Rahovica Commerce" me ATK për shlyerjen e borxhit, duhet sqaruar se ky pretendim është i pabazuar për faktin se tenderuesi i rekomanduar për lot 11 si konzorcium i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit mbi gjendjen ekonomik dhe financiare (ky fakt nuk kontestohet fare as nga parashtruesi). Ndërsa sa i përket pjesës së marrëveshjes duhet sqaruar se marrëveshja është lidhur para datës së publikimit të njoftimit për kontratë (fakt që nuk kontestohet nga parashtruesi). Rrjedhimisht kjo marrëveshje është e lejuar sipas LPP dhe kjo konfirmohet ndër të tjera edhe përmes interpretimit të KRPP nr. 6 të datës 22.11.2022 ku ndër të tjera thuhet se "KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës". Sa i përket pjesës së pretendimeve lidhur çmimet jonormalisht të ulëta nuk janë përmbushur sipas nenit 41 par. 41.3 të RRPP ku përcaktohet "41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30%) më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10 %> më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë".

2. Pretendimet ankimore të Operatorëve Ekonomik ankues në OSHP

2. 1. Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "V.Z. Company" Sh.p.k janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): AK Komuna e Prishtinës, me datën 23/02/2024, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku për Lotin 2 ka rekomanduar për dhënien e kontratës një ofrues tjetër, i cili ka ofertuar me çmim më të lartë se oferta jonë. Përmes letër standarde, oferta jonë është kualifikuar si e papërgjegjshme, me arsyetimin se nuk plotësojmë të gjitha kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional lidhur me makineritë e prezantuar në ofertë, duke theksuar mungesën e dy makinerive mbi 8 tonë. Komisioni vlerësues i ofertave, në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe në pajtim me nenin 10 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik, ka eliminuar ofertën tonë si të papërgjegjshme, megjithatë ne kemi prezantuar prova dhe dëshmi për të argumentuar përgjegjshmërinë tonë. Me eliminimin tonë AK - Komuna e Prishtinës ka shkelur parimet e prokurimit publik, duke tentuar të lidhë kontratë me çmim më të lartë dhe duke keq-përdorur paratë publike. Tentativa për manipulim, keq-përdorim dhe abuzim me paratë publike tregon faktin se ne si operator ekonomik ankues kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim me datën 27/02/2024, duke dhënë argumentet tona. Megjithatë, AK - Komuna e Prishtinës ka nxjerrë vendim të përbashkët më datën 06/03/2024, duke shkelur afatin ligjor për shqyrtimin e kërkesës sonë, që duhej të ishte brenda 3 ditëve pune. Për më tepër, AK duhet të trajtojë vendimin ndaj nesh si operatorit ekonomik të caktuar dhe jo përmes një vendimi që trajton shumë kërkesa për rishqyrtim.

Pretendimi i dytë (II): Sa i përket arsyetimit të eliminimit ku AK ne letrën standarde përcakton se ne si OE nuk kemi prezantuar dy kamion me tonazh min: 8 ton. Kjo paraqet shkelje të dispozitave ligjore dhe si e tillë është në kundërshtim me gjendjen faktike, pasi që ne oferte kemi prezantuar dëshmi ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë. Përkatësisht në dosje të tenderit. AK lidhur me pajisjet teknike për të cilën ne si OE kemi eliminuar në pozicionin 4 ka kërkuar parafrazoje në veten e trette. OE V.Z. Company Sh.P.K. ne oferte ka prezantuar dëshmi dhe prova ku argumentohet se plotësohen të gjitha pajisjet e kërkuara për Lotin 2. Sa i përket kamionëve për pastrimin e bores me kapacitet mbi 8 ton, siç shihet në kërkesë kualifikuese. përkatësisht në aneksin 7 të Lotit 2, AK ka kërkuar kapacitetin e pajisjet me peshe totale. Ne si OE ne oferte sa i përket pajisjeve kemi prezantuar këto dëshmi. Autoriteti Kontraktues bazuar në neni 10 të Udhëzuesit nr. 01/23 për Prokurimin Publik detyrimisht ka qene dashur të kërkojë sqarim shtese nga ne si OE në atë mënyrë që të plotësohet dhe sqarohet oferta për të cilën AK. përkatësisht Komisioni Vlerësues i ofertave ka pasur dilema.

Pretendimi i tretë (III): Bazuar në pretendimet e paraqitura, kërkohet që OSHP dhe eksperti shqyrtues i autorizuar në përputhje me nenin 113 të Ligjit për Prokurimin Publik, të trajtojë në tërësi pretendimet ankimore të subjektit "Anuar" Sh.P.K. Për shqyrtimin e pretendimeve, është e rëndësishme që eksperti shqyrtues të konsiderojë të gjitha provat dhe dëshmitë të cilat "Anuar" Sh.P.K. i ka ngarkuar në platformën E-Prokurimit. Kjo përfshinë dëshmitë e tyre në lidhje me kapacitetet teknike, profesionale, ekonomike dhe financiare, si dhe dëshmitë për realizimin e projekteve në tre vitet e kaluara. Për të siguruar një shqyrtim të drejtë dhe të plotë të ankesës, është e rëndësishme që eksperti të konsiderojë në mënyrë të kujdesshme të gjitha provat dhe faktet e prezantuara, duke mos i shkelur në asnjë mënyrë detyrimet dhe standardet ligjore të prokurimit publik. Për pasojë, kërkesa është që paneli shqyrtues të trajtojë pretendimet në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe në bazë të provave të prezantuara, të nxjerrë një vendim të bazuar dhe të drejtë në lidhje me ankesën e subjektit "Anuar" Sh.P.K.

2. 2. Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "El- BAU" Sh.p.k janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Pretendimet për OE "Rsm Company" OE në fjalë nuk i plotëson kërkesat e specifikuar në kërkesën 4 të DT lidhur me kapacitetin teknik në relacion me mjetet dhe pajisjet e domosdoshme dhe të obligueshme për realizimin e projektit bazuar në faktet dhe rrethanat si në vijim: Nuk i posedon pajisjet për të gjitha lotet ashtu siç kërkohet te pika 2.5 e FTD-së së DT për faktin se me pajisjet e njëjta që i ka paraqitur [4 automjete për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pflug dhe krypore) 3-7.7 ton me peshë totale; dhe 6 kamion për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pflug dhe krypore) > 8 ton me peshë totale, dhe 5 freza dore për largimin e borës në trotuare] ka ofertuar në të gjitha lotet (10) e theksuara si më sipër. Prandaj, situata e cekur e vërteton se OE në fjalë me dëshmitë e ofruara për këto pajisje e plotëson vetëm kërkesën e kapacitetit teknik për Lot 1. Por nuk e plotëson kërkesën e kapacitetit teknik për lot 3, lidhur me pajisjet kamion për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pflug dhe krypore) 8 ton me peshë totale dhe pajisjet automjete për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pflug dhe krypore) 3-7.7 ton me peshë totale, duke qenë se të njëjtat (4 automjete për pastrimin e borës dhe 6 kamion për pastrimin e borës) i ka paraqitur për të gjitha lotet (10 sosh) që ka ofertuar.

Po ashtu nuk e plotëson kërkesën për pajisjen "frezë dore për largimin e borës në trotuare" sepse pavarësisht faktit se kjo pajisje është kërkuar në 9 lote (nga Lot 1 deri te Lot 9), OE në fjalë ka paraqitur pajisjen e njëjtë (5 cope) për të gjitha lotet që ka ofertuar, dhe sipas të cilave e ka plotësuar kërkesën vetëm për lot 1 ku janë kërkuar 5 pajisje të tilla.

Pretendimi i dytë (II): OE në fjalë lidhur me Lot 3 por jo vetëm, nuk i plotëson kërkesat e specifikuar në kërkesën 2 pika a) dhe b) të DT lidhur me kapacitetin profesional në relacion me menaxherin e projektit dhe listën mesatare të punëtorëve të angazhuar për lote, sepse për të gjitha lotet ku ka ofertuar ka paraqitur dëshmitë vetëm për një menaxher të projektit (Hajredin Fetahaj) dhe një listë të punëtorëve (47 punëtorë) të deklaruar në ATK për periudhën e vitit 2023.

Pretendimi i tretë (III): Marrëveshja për themelimin e Grupit të Operatorëve Ekonomik i përbërë nga kompania "RSM Company" sh.p.k. dhe "VB Tofaj" sh.p.k. e lidhur me datë 18.01.2024, nuk është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat e dosjes së tenderit, respektivisht deklaratës apo marrëveshjes për themelimin e GOE sepse, ky dokument sipas titullit dhe përshkrimit e ka karakterin e një dokumenti si Akt - Marrëveshje - Draft Kontratë. Kurse sipas pjesëve/shtojcave tjera që ju kanë bashkëngjitur këtij dokumenti (deklarata për konfirmim pjesëmarrje dhe deklaratë për autorizim të partnerit kryesor), i njëjti nuk është në pajtueshmëri me specifikimet formalo-juridike të nenit 11.1 të DT. Kjo për faktin sepse këtij dokumenti me shtojcat e tij i mungojnë deklaratat e përcaktuara në shkronjën a dhe d të nenit 11.1 të DT të cilat përcaktojnë se: a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. Kësisoj, ky dokument si i tillë përveç se nuk është në pajtueshmëri me

kërkesat e dosjes së tenderit, i njëjti në aspektin juridik nuk është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të paragrafit 4 të nenit 71 lidhur me nenin 65 të LPP. Bazuar në faktet dhe arsyet e paraqitura si më lartë, rezulton se, OE "Rsm Company" SH.P.K. lidhur me Lot 3 por jo vetëm, nuk i ka plotësuar kriteret kualifikuese të kapacitetit teknik dhe profesional të specifikuar në kërkesën nr. 2 dhe 4 të nenit 9.1&9.2 të FTD/DT dhe kriterin e përshtatshmërisë të përcaktuar në nenin 11 të FTD/DT. Prandaj, kjo gjendje faktike vërteton se është i pabazuar vlerësimi i AK-së i dhënë në letrën standarde se OE në fjalë ka paraqitur tender të suksesshëm. Për këto arsye, konsiderojmë se, veprimet dhe aktet e AK-së nuk iu kanë nënshtruar një procedure të ligjshme dhe pa diskriminim për faktin se procesi i vlerësimit të dosjes së OE "Rsm Company" SH.P.K. është bërë në kundërshtim me parimet bazike/themelore të zbatueshme dhe rrjedhimisht në kundërshtim me dispozitat ligjore siç parashihen në LPP në paragrafin 4 të nenit 59 e në ndërlidhje me paragrafin 1.1. të nenit 56, 65 69, 7 dhe 1 të këtij ligji, përfshirë edhe dispozitat e ndërlidhura relevante të RRPP Nr. 001/2022. Për më tepër, OE "Rsm Company", nuk mund ta ketë statusin e palës me interes në kuptim të nenit 4 paragrafit 1.26 të LPP-së në kontekstin sepse nga e tij nuk janë vënë në lëvizje mjetet juridike të përcaktuara me LPP dhe RRPP për kontestimin eventual të rezultatit sipas Letrës Standarde të bashkëngjitur në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të dt. 23.02.2024 me të cilin jeni njoftuar përmes e-prokurimit.

Pretendimi i parë për GOE "Via Egnatia Sh.P.K.&VJV Group L.L.C.& Rahovica Commerce Sh.P.K. &Infrastruktura Sh.P.K.GOE në fjalë nuk e plotëson kërkesën për lot 3, rrjedhimisht në asnjërin lot, lidhur me kërkesën e përshtatshmërisë lidhur me Vërtetimin e Administratës Tatimore të Kosovës të specifikuar në kërkesën 1 (Kërkesat e Përshtatshmërisë) të FTD së DT e cila duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara sipas paragrafit 4.3 dhe 4.8 të me nenit 65 të LPP-së. Për ta përmbushur këtë kriter, në pikën 2 të dëshmisë dokumentare është kërkuar që OE në pikën 2 të operatorët ekonomik duhet të paraqes "Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit". Prandaj ashtu siç shihet, kjo kërkesë është shumë e qartë, sepse në mënyrë specifike përcakton se OE përmes vërtetimit tatimor duhet të dëshmojë se "është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.". Pra, nuk lejon alternativa apo opsione tjera të dëshmime tjera shtesë si psh. marrëveshje me ATK për shlyerjen e borgjeve. Por pavarësisht këtij detyrimi ligjor i cili është specifikuar nga vet kërkesa e AK-së, komisioni i vlerësimit dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit të AK-së e shpërblen me kontratë GOE në fjalë duke i pranuar si të mirëqenë në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit, vërtetimin tatimor me borgje sipas të cilit vërtetohet se anëtar i GOE "Rahovica Commerce" Sh.p.k. është në vonesë për pagimin e tatimeve dhe ka marrëveshje me këste për të shlyer borgjet. Këtë gjendje faktike e vërteton Vërtetimi Tatimor me numër serik 1001137814 të datës 18.01.2024 në emër të anëtarit të grupit të OE në fjalë "Rahovica Commerce" Sh.p.k., i njëjti ka pasur obligime/borgje tatimore të pashlyera dhe është në marrëveshje për të shlyer këto borgje në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë. Gjithashtu, duke u bazuar në dokumentacionin që e kemi siguruar nga qasja zyrtare në dosjen e GOE të shpërblyer me kontratë për lot 3 dhe lotet tjera, është gjetur se i njëjti pas datës së publikimit për kontratë kishte dorëzuar edhe një Marrëveshje me numër protokollit 1063/24, e datës 30.01.2024, për pagesë të borgjeve tatimore me këste në shumën prej 149,956.33€. Marrëveshja e cekur e vërteton se ky borgj ka ekzistuar paraprakisht, rrjedhimisht është i ndërlidhur me borgjin e krijuar sipas vërtetimit tatimor me borgje me numër serik 1001137814 i datës 18.01.2024.

Pretendimi dyte (II): GOE në fjalë në dosjen e tij për lot 3 por dhe lotet tjera, nuk e ka paraqitur listën e pajisjeve/mekanismit të obligueshëm sipas Aneksit 7 dhe konform parashikimeve ligjore të prokurimit sipas paragrafit 4.5 të LPP-së, sepse lista e paraqitur nga ana e GOE nuk e përmban përshkrimin e nevojshëm që duhet ta përmbajë duke përfshirë: llojin apo tipin e pajisjes, vitin e prodhimit, ngjyrën, numrin e regjistrimit, pronësinë apo posedimin e saj të OE. Në mënyrë që ta keni më të qartë këtë fakt, shih në aspektin krahasues listën e GOE në fjalë me listën e shumicës së OE ankues dhe shumicës së OE tjerë pjesëmarrës. Por i njëjti ka bashkëngjitur vetëm Aneksin 7 të dosjes së tenderit. Prandaj, tenderi i GOE të lartcekur nuk është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit (kërkesa 4) ashtu siç parashikohet me paragrafin 6 të nenit 40 të RRPP.

Pretendimi trete (III): OE në fjalë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e specifikuara në kërkesën 4 të DT lidhur me kapacitetin teknik në relacion me mjetet dhe pajisjet e domosdoshme dhe të obligueshme për realizimin e projektit për lot 3, sepse automjeti/kamioni i prezantuar me tabela 05-647-GF i Modelit MAN L 2000, nuk e plotëson kërkesën e dosjes lidhur me pajisjen e kërkuar automjet për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pflug dhe krypore) 3-7.5 ton me peshë totale. Kjo për faktin se, pajisja në fjalë që është prezantuar nga GOE për lot 3, bazuar në përshkrimin e specifikacionit, respektivisht destinacionit, nuk është kamion për borë ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit, andaj nuk e plotëson kërkesën e 4 të DT për lot 3. Kurse për të njëjtën pajisje që GOE e ka paraqitur për Lot 1, ku kërkesa e DT është e njëjta sikurse tek kërkesa 4 e lotit 3, AK ka vendosur me të drejtë që ta diskualifikojë si të papërgjegjshëm GOE në fjalë. Pra kjo situatë vërteton se nga ana e AK-së përdoren standarde të dyfishta të vlerësimit që krijojnë favore të hapura për GOE dhe disfavore për OE ankues, pavarësisht faktit se AK-ja është e vetëdijshme se ky veprim është në kundërshtim me kërkesat e DT dhe parashikimet ligjore sipas paragrafit 1 dhe 4.5 të nenit 69 të LPP.

2. 3. Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AVAG Group SH.P.K” janë parashtruar si në vijim:

OE ankues përmes ankesës të parashtruar nga avokati sipas autorizimit, pretendon që AK gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e procedurës së vlerësimit, dhe ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabueshëm të dispozitave të drejtës materiale LPP-së. Sepse, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në përputhje me nenin 59, 60, 7 dhe dispozitave tjera relevante të LPP-së duke i shkaktuar pasoja OE ankues, për faktin se AK e ka rekomanduar me dhënien e kontratës për LOT 11 GOE “Via Egnatia Sh.P.K. & VJV Group L.L.C.& Rahovica Commerce Sh.P.K. & Infrastruktura Sh.P.K. Dega Në Kosovë” i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat kualifikuese të dosjes së tenderit dhe për më tepër pretendohet se ka paraqitur tender jo-normalisht të ulët. Gjithashtu OE ankues pretendon se edhe tenderi i paraqitur nga GOE tjetër i radhitur para tij “Alko Impex & General Construction & Company Murseli & Ntsh Krasniqi” është i papërgjegjshëm me arsyetimin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat kualifikuese të dosjes së tenderit dhe ka paraqitur tender jo-normalisht të ulët.

Lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të OE ankues, të deponuar në AK më 28.02.2024, AK përmes vendimit të saj të datës 07.03.2024 kishte vendosur që t’u refuzoj si të pabazuar kërkesën e OE ankues dhe e ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 23.02.2024. Kundër këtij vendimi dhe veprimeve të AK-së që lidhen me të njëjtin, OE ankues ka paraqitur një mori pretendimesh ankimore për shkelje esenciale procedurale dhe materiale.

OE ankues pretendon që AK me veprimet dhe vendimin për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale dhe materiale të LPP-së, për faktin se nuk e ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit ashtu siç e obligon paragrafi 2 i nenit 108/A të LPP-së, nuk e ka shqyrtuar kërkesën brenda afatit ligjor siç përcaktohet me paragrafin 6 të nenit 108/A të LPP-së, prej 3 ditë pune nga data e parashtrimit dhe afatit shtesë edhe 3 ditë tjera, dhe nga ana tjetër pohimeve se arsyetimi i vendimit të atakuar nuk e ka argumentuar me prova dhe një arsyetim të arsyeshëm ligjor gjendjen e plotë faktike dhe bazën ligjore të vendimit në të cilat i bazon konstatimet dhe pse është e zbatueshme në rastin konkret.

OE ankues pretendon që AK ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderit të paraqitur nga GOE në fjalë nuk e ka bërë në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së sepse i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret kualifikuese të kapacitetit teknik dhe profesional të specifikuara në lidhje me kërkesën nr. 4 të nenit 9.1&9.2 të FTD/DT, dhe nga ana tjetër se ka paraqitur tender jo-normalisht të ulët.

OE ankues pretendon që AK ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderit të paraqitur për LOT 11 nga GOE “Via Egnatia Sh.P.K.&VJV Group L.L.C.& Rahovica Commerce Sh.P.K. &Infrastruktura Sh.P.K. Dega në Kosovë” e ka bërë në kundërshtim përcaktimet e paragrafit 4 të nenit 59 të LPP-së dhe nenit 40 pika 1 dhe 6 e RRPP lidhur me dispozitat tjera relevante nga nenet 1,7, 61, 65, 69 të LPP-së, me arsyetimin

tenderi/oferta e tij është e papërgjegjshme/papranueshme në tri aspekte, sepse nuk e ka plotësuar kriterin e pranueshmërisë të specifikuar në nenin 6.4 të FTD-së për situatën e referuar në kërkesën 1, dëshminë 2 për vërtetimin tatimor të ATK-së, nuk i ka plotësuar kriteret kualifikuese të kapacitetit teknik lidhur me kërkesën 4 të pikës 9.1&9.2 të FTD-së, nuk e ka paraqitur listën e pajisjeve/mekanizmit të obligueshëm sipas Aneksit 7 dhe konform paragrafit 4.5 të nenit 69 LPP-së, dhe se ka paraqitur tender jo-normalisht të ulët në kuptim të nenit 61 paragrafi 2 të LPP-së dhe nenit 17.32 të RRPP Nr. 001/2022.

OE ankues pretendon që GOE të lartcekur nuk e plotëson kushtet formale dhe administrative të dosjes së tenderit për LOT 11 duke qenë se nuk e ka paraqitur listën e pajisjeve/mekanizmit të obligueshëm sipas Aneksit 7 dhe konform parashikimeve ligjore të prokurimit sipas paragrafit 4.5 të nenit 69 të LPP-së. Sepse sipas këtij pretendimi lista e paraqitur nga ana e GOE nuk e përmban përshkrimin e nevojshëm që duhet t'a përmbajë duke përfshirë: llojin apo tipin e pajisjes, vitin e prodhimit, ngjyrën, numrin e regjistrimit, pronësinë apo posedimin e saj të OE.

OE ankues pretendon që GOE të lartcekur nuk i plotëson të gjitha kërkesat e specifikuara në kërkesën 4 të DT lidhur me kapacitetin teknik në relacion me mjetet dhe pajisjet e domosdoshme dhe të obligueshme për realizimin e projektit, me arsyetimin se bazuar në dokumentacionin e prezantuar kamioni i modelit MAN L 2000 me tabela të regjistrimit 05-647-GF nuk e plotëson, rrjedhimisht nuk është në pajtueshmëri me kërkesën lidhur me pajisjen e përcaktuar si "automjet për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pllug dhe krypore) 3-7.5 ton me peshë totale." Në lidhje me këtë çështjen, ankuesi pretendon se AK ka përdorur standarde të dyfishta dhe kontradiktore të vlerësimit diskriminues, me arsyetimin se për pajisjen e njëjtë e ka diskualifikuar GOE për LOT 1, kurse e kualifikon për LOT 11.

OE ankues pretendon që GOE të lartcekur ka paraqitur tender jonormalisht të ulët në kuptim të paragrafit 2 të nenit 61 të LPP-së nëpërmjet çmimeve manipulative që në mënyrë substanciale janë nën nivelin e çmimeve reale të tregut, përfshirë edhe krahasimin e saj në kontekstin e vlerës së parashikuar të kontratës në shumën prej 194,000.00€, vlerë e cila është përcaktuar pas hulumtimit dhe krahasimit të çmimeve të tregut, strukturës së tregut dhe tendencave të kostos së mundshme të prokurimit përkatës, çmimeve të kontratave paraprake nga kontratat e njejta nga ana e AK-së sipas nenit 13 të RRPP Nr. 001/2022 dhe Udhëzuesit për Analizën e Tregut i nxjerrë nga KRPP dhe publikuar me datë 12.04.2023 në ueb faqen e KRPP-së. Ashtu që sipas OE ankues oferta e GOE me çmimin prej 138,201.91€ është për 28% më e lire se vlera e parashikuar e kontratës, gjersa të gjitha ofertat tjera të përgjegjshme janë të përfaqësuara me vlerën e parashikuar. Prandaj si dëshmi ka paraqitur një tabelë ku pasqyrohet një analizë financiare krahasimore me çmime të ndryshme lidhur me elementet e tenderit me përshkrim të njëjtë të punëve për të cilat pretendon se janë me çmime jo-normalisht të ulët.

- Administrimi i provave dhe vlerësimi -

3. Vlersimet e ekspertës shqyrtuese

3.1-Vleresimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 210/24 të operatorit ekonomik "V.Z. Company" Sh.P.K .

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19. 03. 2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 210/24 ndërsa me datë 08. 04. 2024 u dorëzuar raporti e ekspertizës të ekspertës shqyrtuese.

Lidhur me ankesën nr. 210/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda për LOT 2 të kthehet në rivlerësim".

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar me mendimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese, ndërsa operatori ekonomik është deklaruar se pajtohet.

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, bazuar në platformën E-prokurim, nga provat dhe shkresat e lëndës vërtetohet se OE ankues “V.Z.Company” me datën 27.02.2024 ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK – Komunës së Prishtinës kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 23.02.2024 lidhur me LOT 2. AK kërkesën për rishqyrtim nuk ka shqyrtuar brenda afatit 3 ditë, në anën tjetër nuk ka njoftuar ankuesin për zgjatje të afatit shtesë, dhe rrjedhimisht nuk ka shqyrtuar kërkesën as brenda afatit shtesë, bazuar në e-prokurim, vendimi është publikuar në ditën e tetë konkretisht me datë 07.03.2023, andaj AK ka shkelur nenin 108/A paragrafi 6 i LPP-së, andaj sipas sqarimeve më lartë ekspertja shqyrtuese pretendimin e OE ankues e konsideron të bazuar. Tutje, lidhur me aktivitetin e prokurimit LOT 2, AK këtë pjesë ka kthyer në rivlerësim, për faktin se ka aprovuar kërkesat e disa operatorëve ekonomik në procedure

Pretendimi i dytë i OE ankues: OE ankuesi pretendon se AK nuk ka vlerësuar drejt ofertat, për faktin se nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit, duke i arsyetuar me fakte dhe argumente. Gjersa, pas analizimit të shkresave të lëndës të dokumentuara në E-prokurim, ekspertja shqyrtuese sqaron se, në ofertën e OE ankuesit gjendet, lista e pajisjeve, e cila sa i përket kamionëve 3-7.5 ton dhe ≥ 8 ton, i njëjti ka të prezantuar 7 kamion të cilat ishin të përziera me numra të targave, mirëpo megjithatë, OE ankues sipas ofertës së bashkangjitur, posedon 2 kamion me peshë ≥ 8 ton (kërkesa e AK-së ka qenë 4 kamion), 2 kamion me peshë 3-7.5 ton (pra siç kërkohet nga AK), por gjithashtu i njëjti ka bashkangjitur edhe dy librezat, të cilat njëra nuk shihet qartë pesha, ndërsa tjetra është kamion special për pastrim të bores në pronësi, e cila në librezë ka të vendosur vetëm peshën e automjetit 6.800kg, çka do të thotë se, nuk e ka të përfshirë peshën totale (siç ka specifikuar AK në DT, pesha totale). Në rastin konkret, ekspertja shqyrtuese konsideron se, AK meqenëse LOT (2), ka kthyer në rivlerësim, si e tillë rekomandoj që edhe OE ankues duhet të sqarohet konform nenit 72 të LPP-së, në mënyrë që të respektohet neni 7 i LPP-së, trajtim i barabartë në vlerësim për dokumentet të cilat janë në ofertë, në këtë rast librezat, për arsye se ky kamion e përcakton përgjegjshmërinë e tij. Andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i OE ankues kundër OE “Anuar” SHPK: OE ankuesi pretendon se OE Anuar Shpk nuk e plotëson kriterin lidhur me pajisjet e ofruara, sepse i njëjti ka ofertuar për më tepër lote, andaj duhet që ti posedoj dyfishin, gjithashtu pretendon se AK ka aprovuar kërkesën për rishqyrtim pa drejtësisht. Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të bashkangjitura në e-prokurim, krahasuar me pretendimet ankimore të parashtruara në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, si rrjedhojë, konform RRPP-së neni 64.2 Paraqitja e ankesës dhe afatet kohore për dorëzimin e një ankese në OSHP, ky pretendim ankimor i ngritur në ankesë, nuk mund të shqyrtohet, për faktin se nuk ka qenë i parashtruar pranë AK-së.

Si rrjedhojë, OE ankues lidhur me arsyet e eliminimit pretendon se i plotëson kriteret, përderisa sipas sqarimeve më lartë, kontestuese është librezat e cila nuk e posedon peshën totale, atëherë si e tillë, rekomandohet AK që të sqarohet me njësinë kërkuese/ komisionin profesional lidhur me librezën, për faktin se kjo përcakton përgjegjshmërinë e OE ankues. Vlen të theksohet se, OE ankues ka parashtruar pretendim edhe kundër OE Anuar Shpk lidhur me pajisjet e ofruara, mirëpo ky pretendim ankimor konform RRPP-së nr.001/2022 neni 64.2 nuk mund të shqyrtohet, për faktin se nuk ka qenë i ngritur në kërkesën për rishqyrtim. Si përfundim, sqarojmë se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë parashtruar tri ankesa pranë OSHP-së përkatësisht për pjesët LOT 2 lënda me nr.210/24, LOT 3 lënda me nr.233/24 dhe LOT 11 lënda me nr. 234/24. Të cilat ankesa janë shqyrtuar objektivisht në mënyrë individuale duke rezultuar në rekomandimin “Rivlerësim”, për faktin se sipas sqarimeve nëpër pretendimet ankimore, të njëjtat gjenden të bazuara, andaj si e tillë ekspertja shqyrtuese konsideron se pjesët LOT 2, LOT 3 dhe LOT 11 duhet të rivlerësohen konform dispozitave ligjore të LPP-së.

3.2-Vleresimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 233/24 të operatorit ekonomik “El-Bau SH.P.K.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22. 03. 2024 ka autorizuar ekspertën shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 233/24 ndërsa me datë 08. 04. 2024 u dorëzua raporti ekspertizës të ekspertës shqyrtuese.

Lidhur me ankesën nr. 233/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda LOT 3 të kthehet në rivlerësim”.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar lidhur me mendimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese, ndërsa operatori ekonomik është deklaruar se pajtohet.

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, bazuar në platformën E-prokurim, AK nuk ka pezulluar aktivitetin e prokurimit konform nenit 108/A paragrafi 2 i LPP-së, e cila e obligon autoritetin kontraktues që ta pezulloj aktivitetin e prokurimit në momentin e dorëzimit të një kërkesë për rishqyrtim. Gjithashtu AK kërkesën nuk ka shqyrtuar brenda afatit 3 ditë, në anën tjetër nuk ka njoftuar ankuesin për zgjatje të afatit shtesë, dhe rrjedhimisht nuk ka shqyrtuar kërkesën as brenda afatit shtesë, bazuar në e-prokurim, vendimi është publikuar në ditën e tetë konkretisht me datë 07.03.2023, andaj AK ka shkelur nenin 108/A paragrafi 6 i LPP-së. Tutje, gjithashtu edhe arsyeja e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim është në kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 12, e cila përcakton se, kundërshtimet dhe vendimet e miratuara duhet të jenë të arsyetuara, si e tillë, AK nuk ka argumentuar dhe arsyetuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, andaj sipas sqarimeve më lartë ekspertja shqyrtuese pretendimin e OE ankues e konsideron të bazuar. Me fjalë të tjera, ekspertja shqyrtuese sqaron se, mos zbatimi i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim dhe mos respektimi i afateve kohore për nxjerrjen e vendimit lidhur me kërkesën për rishqyrtim, si e tillë klasifikohet si shkelje e rende sipas nenit 97 paragrafi 1, pika e të rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik. Kurse, sa i përket arsyesimit tjetër të AK-së që është përdorur për refuzim të kërkesës për rishqyrtim duke theksuar se OE ankues është palë pa interes me arsyetimin se RSM nuk është i rekomanduar për LOT 3 por për një tenderues tjetër, në lidhje me këtë çështje, ekspertja shqyrtuese konsideron se një konstatim i tillë i AK-së nuk qëndron i bazuar. Kjo për faktin se OE ankues i ka plotësuar të dy kushtet për tu trajtuar si palë me interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit për lot 3 në kuptim të nenit 4 par.1.26 të LPP-së, sepse oferta e tij është e përgjegjshme siç vërtetohet me vendim të AK-së dt. 23.02.2024 dhe nga ana e tjetër përveç pretendimeve të paraqitura kundër GOE të rekomanduar për kontratë, janë paraqitur pretendime të argumentuara me prova konkrete për OE të dytë ”RSM Company” SHPK që është me çmimin më të lire se sa oferta e OE ankues.

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës në platformën elektronike e-prokurimi, konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar. Për faktin se OE “RSM Company” Sh.p.k. i ka paraqitur pajisjet e njëjta për të gjitha lotet në të cilat ka marrë pjesë, nisur nga lot 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, pavarësisht se në pikën 2.5 të dosjes së tenderit është sqaruar qartë se operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë pajisjet për secilën lot që ofertojnë.

Lidhur me llojin e mekanizmit dhe pajisjes “Automjet për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pllug dhe krypore) 3-7.5 tonë me peshë totale” e cila është kërkuar nga lot 1 deri lot 9 dhe lot 12, ka ofertuar me 4 të tilla për të gjitha lotet, nisur nga lot 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Lidhur me llojin e mekanizmit dhe pajisjes “Kamion për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pllug dhe krypore) ≥8 tonë me peshë totale, e cila është kërkuar në të gjitha lotet, 14 sosh, ka ofertuar me 6 të

tilla për të gjitha lotet, nisur nga lot 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Lidhur me llojin e mekanizmit dhe pajisjes “Freza dore për largimin e borës në trotuar” e cila është kërkuar nga lot 1 deri lot 9, ka ofertuar me 5 të tilla për të gjitha lotet, nisur nga lot 1, 2, 4, 6, 7, 8 dhe 9.

Është e rëndësishme të theksohet se, AK në letrën standarde B42 për kandidatin e eliminuar ka specifikuar se OE RSM Company Shpk nuk i plotëson kriteret për të gjitha lotet lidhur me pajisjen 3.5 ton.

Si rrjedhojë, pas analizimit dhe shqyrtimit të ofertës së OE RSM Company Shpk, në listën e pajisjeve është cekur se janë 6 kamion për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pflug dhe krypore) -8 ton, kurse sipas librezave të paraqitura vërejmë se OE në fjalë posedon pesë kamion të cilët janë të specifikuar në librezë “Kamion me vinq për pastrimin e rrugëve nga bora”, kurse kërkesa kamion për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pflug dhe krypore) -3-7.5 ton, në ofertë nuk i plotëson asnjë librezë kërkesat, dhe si e tillë OE në fjalë gjithashtu sipas eliminimit të AK-së në letrën B42, nuk i plotëson kriteret për të gjitha lotet, përkatësisht nuk plotëson kriterin për LOT 3, për faktin se nuk posedon në ofertë kamion për pastrimin e borës 3-7.5 ton, andaj sipas sqarimeve më lartë OE RSM Company për LOT 3 është i pa përgjegjshëm.

Përgjigje në pretendimin lidhur me vendimin e AK-së pika e 6, refuzimi i kërkesës për rishqyrtim: Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës në e-prokurim, konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar. Sepse siç vërtetohet nga dokumentacioni i paraqitur nga OE “Rsm Company” Sh.p.k, për të gjitha lotet që ka ofertuar (1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11) lidhur me kriterin për stafin profesional të specifikuar në kërkesën 2 pika a) “Menaxher i projektit inxhinier i ndërtimtarisë apo bachelor (drejtimi konstruktiv)” ka paraqitur dokumentacionin vetëm për një menaxher të projektit, konkretisht për z.H.F. folderi nr.8 në ofertë. Gjithashtu për të gjitha lotet që ka ofertuar ka paraqitur listën e punëtorëve për 47 punëtorë të deklaruar në ATK për periudhën e vitit 2023.

Përgjigje në pretendimet ankimore lidhur me OE “RSM Company Shpk”

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të bashkangjitura në e-prokurim, konsideron se pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar. Sepse dokumentacioni i paraqitur nga OE “RSM Company” Sh.p.k. i titulluar si “Akt-Marrëveshje – Draft Kontratë”, përtej faktit se sipas titullit është paraqitur si “draft” nuk është në pajtueshmëri me kërkesën e specifikuar me nenin 11 pika 1.

Tutje, në ofertën e OE në fjalë, është e bashkangjitur AKT marrëveshja-Draft kontratë, e cila nuk specifikon qartë deklaratat, kurse i njëjti ka të bashkangjitur vetëm dy deklaratat të cilat e plotësojnë pikën b dhe c, përderisa sipas RRPP-së nenit 26.1 dhe 26.2, operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë deklaratat veç e veç sipas pikave a,b,c ose mund të dorëzojnë një deklaratë të vetme e cila përfshinë tri pikat, andaj si e tillë OE në fjalë në draft kontrata nuk i ka të përfshira 3 pikat, përkundër që edhe sipas emërimit të këtij dokumenti “Draft” konsideroj se nuk mund të jetë e pranueshme, për faktin se drafti është dokument që në çdo kohë mund të përmirësohet, ndërsa kontrata është marrëveshje e cila posedon kushtet, efektet etj, e cila në rast mosmarrëveshjeje mund të atakohet në organet kompetente. Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, sqarojmë se, AK në DT neni 6.4. Gjithashtu neni 65 paragrafi 5 i LPP-së përcakton se, periudha kohore paraprinë me datën e publikimit të njoftimit për kontratë, përkundër që AK ka specifikuar që, periudha para dorëzimit të tenderit.

Si e tillë, pas analizimit të dokumentacionit të bashkangjitur nga OE i rekomanduar në platformën e-prokurimi, ekspertja shqyrtuese ka gjetur se anëtar i GOE i rekomanduar me kontratë “Rahovica Commerce Shpk” ka paraqitur vërtetimin tatimor nr.1001137814 të dt.18.01.2024 në kundërshtim thelbësor me kërkesën 1/dëshmia 2 të nenit 6.4 të FTD-së të dosjes së tenderit, ku shprehimisht për t'a plotësuar këtë kërkesë është kërkuar që operatorët ekonomik duhet të paraqesin ”Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk

është në vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit” Ky fakt argumentohet me vërtetimin tatimor të paraqitur nga GOE i rekomanduar me kontrate, OE ”Rahovica Commerce SHPK” ka borxhe tatimore te pa shlyera në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje për shlyerje te borxheve të mbetura. Pra, situata e cekur e vërtetohet se anëtarin e GOE i rekomanduar për kontratë është në vonesë për pagimin e borxheve deri ne tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit. Lidhur me këtë çështje ekspertja shqyrtuese sqaron se, ne kërkesën 1/dëshmia 2 te nenit 6.4 te FDT-se nuk është parashikuar një mundësi tjetër e ofrimit të vërtetimit tatimor me borxhe, marrëveshja për shlyerjen e borxheve apo që kjo situatë te dëshmohej përmes një dokumenti tjetër shtese apo alternative si psh. Marrëveshje për shlyerje te borxheve etj. Në këtë kontekst ekspertja shqyrtuese konsideron se AK gjate procesit të vlerësimit nuk ka pasur të drejtë të aplikoj kritere me karakter favorizues në dobi dhe interes të GOE i cili nuk ka përcaktuar ne dosje të tenderit. Ngase ky veprim është ne kundërshtim me nenin 59 lidhur me nenin 7 te LPP-se.

Përveç kësaj ekspertja shqyrtuese sqaron se, vërtetimi tatimor nr. 100137814 i dt. 18.01.2024 i lëshuar për anëtarin e GOE të rekomanduar është pas datës së publikimit të njoftimit për kontrate në e-prokurim qe është 29.11.2023. Andaj si e tille është në kundërshtim me periudhën e përcaktuar në nenin 65 par. 5 të LPP-së i cili përcakton: ”Periudhat kohore të përcaktuara në këtë Nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin ftesës për pjesëmarrje ose tenderim”

Krahas situatës së lartë cekur, ekspertja shqyrtuese vlerëson se është marrëveshja me numër protokollit 21709 e datës 30.01.2024 e lidhur ne mes ATK dhe anëtarit te GOE “Rahovica Commerce SHPL” për pagesë të borxheve tatimore me këste në shumën prej 149.956.33 euro është ne kundërshtim me kërkesën 1/ dëshmia 2 te nenit 6.4 te FTD-se dhe me kundërshtim me dispozitën e nenit 65 par.4.8 te LPP-se. Kjo për faktin se në kërkesën e larte cekur te DT-së nuk është parashikuar një mundësi tjetër shtese. Përveç tjerash ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo marrëveshje e dorëzuar në AK pas periudhës se publikimit te njoftimit për kontratë te dt.19.11.2023 edhe pas periudhës së hapjes së ofertave me dt.22.01.2024 dhe si e tille edhe nëse hipotetikusht të ishte pjesë e kërkesës në dosje të tenderit, e njëjta është dorëzuar ne kundërshtim me periudhën kohore te përcaktuar me nenin 65 par.5 te LPP-së.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 65 paragrafi 5 i LPP-së, si dhe kërkesat në dosje të tenderit, interpretimi i KRPP-së nr.6 i datës 22.11.2022, vendimi i panelit shqyrtues 2023/0386 i datës 21.07.2023, nënkupton se OE nuk ka sjellë të gjitha dëshmitë e pranueshmërisë konform nenit 65 par.5, marrëveshja me nr. 21709 e datës 30.01.2024 për shlyerje të borxheve është e themeluar pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë, përkatësisht edhe pas datës së dorëzimit të ofertave, dhe si e tillë sipas sqarimeve, ekspertja shqyrtuese konstaton se GOE i rekomanduar për kontratë LOT 3 është i papërgjegjshëm.

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues: Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës në e-prokurim, konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar. Sepse siç vërtetohet nga dokumentacioni i paraqitur nga OE “Rsm Company” Sh.p.k, për të gjitha lotet që ka ofertuar (1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11) lidhur me kriterin për stafin profesional të specifikuar në kërkesën 2 pika a) “Menaxher i projektit inxhinier i ndërtimtarisë apo bachelor (drejtimi konstruktiv)” ka paraqitur dokumentacionin vetëm për një menaxher të projektit, konkretisht për z.H.F. folderi nr.8 në ofertë. Gjithashtu për të gjitha lotet që ka ofertuar ka paraqitur listën e punëtorëve për 47 punëtorë të deklaruar në ATK për periudhën e vitit 2023.

Përgjigje në pretendimin e tretë të OE ankues: Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të bashkangjitura në e-prokurim, konsideron se pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar. Sepse dokumentacioni i paraqitur nga OE “RSM Company” Sh.p.k. i titulluar si “Akt-Marrëveshje – Draft Kontratë”, përtej faktit se sipas titullit është paraqitur si “draft” nuk është në pajtueshmëri me kërkesën e specifikuar me nenin 11 pika 1. Tutje, në ofertën e OE në fjalë, është e bashkangjitur AKT marrëveshja-Draft kontratë, e cila nuk specifikon qartë deklaratat, kurse i njëjti ka të bashkangjitur vetëm dy deklarata të cilat e plotësojnë pikën b dhe c, përderisa sipas RRPP-së nenit 26.1 dhe 26.2, operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë deklaratat veç e veç sipas pikave a,b,c ose mund të

dorëzojnë një deklaratë të vetme e cila përfshinë tri pikat, andaj si e tillë OE në fjalë në draft kontrata nuk i ka të përfshira 3 pikat, përkundër që edhe sipas emërimit të këtij dokumenti “Draft” konsideroj se nuk mund të jetë e pranueshme, për faktin se drafti është dokument që në çdo kohë mund të përmirësohet, ndërsa kontrata është marrëveshje e cila posedon kushtet, efektet etj, e cila në rast mosmarrëveshjeje mund të atakohet në organet kompetente. Gjithashtu, ekspertja shqyrtuese vlerëson se në këtë rast OE “RSM Company Shpk:” ne proces te mëtutjeshëm nuk mund të ketë statusin e palës me interes ne kuptim të nenit 4 par.1.26 te LPP-së sepse nga ana e tij nuk janë vënë në lëvizje mjetet juridike të përcaktuara me LPP dhe RRPP, për faktin se, pas vendimit mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim për LOT 3 nga AK, OE në fjalë nuk ka vazhduar me ankesë në OSHP.

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues kundër GOE të rekomanduarit: Pas analizimit të dokumentacionit të bashkangjitur nga OE i rekomanduar në platformën e-prokurimi, ekspertja shqyrtuese ka gjetur se anëtari i GOE i rekomanduar me kontratë “Rahovica Commerce Shpk” ka paraqitur vërtetimin tatimor nr.1001137814 të dt.18.01.2024 në kundërshtim thelbësor me kërkesën 1/dëshmia 2 të nenit 6.4 të FTD-së të dosjes së tenderit, ku shprehimisht për t’a plotësuar këtë kërkesë është kërkuar që operatorët ekonomik duhet të paraqesin ”Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit” Ky fakt argumentohet me vërtetimin tatimor të paraqitur nga GOE i rekomanduar me kontrate, OE ”Rahovica Commerce SHPK” ka borxhe tatimore te pa shlyera në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje për shlyerje te borxheve të mbetura. Pra, situata e cekur e vërteton se anëtari i GOE i rekomanduar për kontratë është në vonesë për pagimin e borxheve deri ne tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit. Lidhur me këtë çështje ekspertja shqyrtuese sqaron se, ne kërkesën 1/dëshmia 2 te nenit 6.4 te FDT-se nuk është parashikuar një mundësi tjetër e ofrimit të vërtetimit tatimor me borxhe, marrëveshja për shlyerjen e borxheve apo që kjo situatë te dëshmohet përmes një dokumenti tjetër shtese apo alternative si psh. Marrëveshje për shlyerje te borxheve etj. Në këtë kontekst ekspertja shqyrtuese konsideron se AK gjate procesit të vlerësimit nuk ka pasur të drejtë të aplikoj kritere me karakter favorizues në dobi dhe interes të GOE i cili nuk ka përcaktuar ne dosje të tenderit. Ngase ky veprim është ne kundërshtim me nenin 59 lidhur me nenin 7 te LPP-se. Përveç kësaj ekspertja shqyrtuese sqaron se, vërtetimi Tatimor nr. 100137814 i dt. 18.01.2024 i lëshuar për anëtarin e GOE të rekomanduar është pas datës së publikimit të njoftimit për kontrate në e-prokurim qe është 29.11.2023. Andaj si e tille është në kundërshtim me periudhën e përcaktuar në nenin 65 par. 5 të LPP-së i cili përcakton:” Periudhat kohore të përcaktuara në këtë Nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin ftesës për pjesëmarrje ose tenderim”

Krahas situatës së lartë cekur, ekspertja shqyrtuese vlerëson se është marrëveshja me numër protokollit 21709 e datës 30.01.2024 e lidhur ne mes ATK dhe anëtarit te GOE “Rahovica Commerce SHPL” për pagesë të borxheve tatimore me këste në shumën prej 149.956.33 euro është ne kundërshtim me kërkesën 1/ dëshmia 2 te nenit 6.4 te FTD-se dhe me kundërshtim me dispozitën e nenit 65 par.4.8 te LPP-se. Kjo për faktin se në kërkesën e larte cekur te DT-së nuk është parashikuar një mundësi tjetër shtese. Përveç tjerash ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo marrëveshje e dorëzuar në AK pas periudhës se publikimit te njoftimit për kontratë te dt.19.11.2023 edhe pas periudhës së hapjes së ofertave me dt.22.01.2024 dhe si e tille edhe nëse hipotetikisht të ishte pjesë e kërkesës në dosje të tenderit, e njëjta është dorëzuar ne kundërshtim me periudhën kohore te përcaktuar me nenin 65 par.5 te LPP-së. Si rrjedhojë, bazuar në nenin 65 paragrafi 5 i LPP-së, si dhe kërkesat në dosje të tenderit, interpretimi i KRPP-së nr.6 i datës 22.11.2022, vendimi i panelit shqyrtues 2023/0386 i datës 21.07.2023, nënkupton se OE nuk ka sjellë të gjitha dëshmitë e pranueshmërisë konform nenit 65 par.5, marrëveshja me nr. 21709 e datës 30.01.2024 për shlyerje të borxheve është e themeluar pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë, përkatësisht edhe pas datës së dorëzimit të ofertave, dhe si e tillë sipas sqarimeve, ekspertja shqyrtuese konstaton se GOE i rekomanduar për kontratë LOT 3 është i papërgjegjshëm.

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues kundër GOE të rekomanduarit: OE ankues pretendon që GOE të lartcekur nuk e plotëson kushtet formale dhe administrative të dosjes së tenderit për LOT 3 për

faktin se nuk e ka paraqitur listën e pajisjeve/mekanizmit të obligueshëm sipas Aneksit 7 dhe konform parashikimeve ligjore të prokurimit sipas paragrafit 4.5 të nenit 69 të LPP-së. Sepse sipas këtij pretendimi lista e paraqitur nga ana e GOE nuk e përmban përshkrimin e nevojshëm që duhet t'a përmbajë duke përfshirë: llojin apo tipin e pajisjes, vitin e prodhimit, ngjyrën, numrin e regjistrimit, pronësinë apo posedimin e saj të OE. Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, konkretisht listës të pajisjeve/mekanizmit të obligueshëm sipas Aneksit 7 që është paraqitur nga GOE në fjalë, konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar, për faktin se GOE në dosjen për LOT 3 e ka bashkëngjitur vetëm Aneksin 7 (Pajisjet dhe Mekanizmi i Obligueshëm) i cili përmban rubrikat për të dhënat vetëm për llojin e pajisjeve të kërkuara dhe sasinë e kërkuar (copë). Por nuk e ka paraqitur në listën e pajisjeve llojin e makinerisë, nr e tragave, ose cafrdo informate e cila nënkupton se cilat pajisje i posedon në ofertë, për faktin se, gjatë vlerësimit të ofertave, në rast se duhet të kërkohet sqarime, atëherë, nëse në listë nuk ka të specifikuar llojin, nr etj, atëherë nuk mund të sqarohet, sepse i bie ndryshim material. Si e tillë lista e pajisjeve duhet të përmbajë informatat e nevojshme, në mënyrë që në rast sqarimi mund të lejohet. Shikuar objektivisht, kjo situatë vërtetohet nga faktet e lartcekura duke qenë se GOE nuk ka paraqitur listën e pajisjeve apo mekanizmit të obligueshëm sipas nenit 69 paragrafi 4 në të cilin thuhet qartë se të dhënat lidhur me aftësinë teknike të OE mund të parashtrihen përmes një ose më shumë mjeteve sipas llojit, sasisë në vijim: nën paragrafi 5: raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve.

Përgjigje në pretendimin e tretë të OE ankues kundër GOE të rekomanduarit: OE ankues pretendon që GOE të lartcekur nuk i plotëson të gjitha kërkesat e specifikuar në kërkesën 4 të DT lidhur me kapacitetin teknik në relacion me mjetet dhe pajisjet e domosdoshme dhe të obligueshme për realizimin e projektit, me arsyetimin se bazuar në dokumentacionin e prezantuar kamioni i modelit MAN L 2000 me tabela të regjistrimit 05-647-GF nuk e plotëson, rrjedhimisht nuk është në pajtueshmëri me kërkesën lidhur me pajisjen e përcaktuar si “automjet për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pflug dhe krypore) 3-7.5 ton me peshë totale.” Në lidhje me këtë çështje, ankuesi pretendon se AK ka përdorur standarde të dyfishta dhe kontradiktore të vlerësimit diskriminues, me arsyetimin se për pajisjen e njëjtë e ka diskualifikuar GOE për LOT 1, kurse e kualifikon për LOT 3.

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar. Sepse është fakt se për shkak të pajisjes së njëjtë, kamioni i modelit MAN L 2000 me tabela të regjistrimit 05-647-GF e diskualifikon nga LOT 1 me arsyetimin se “mungojnë makineritë 3-7.5 ton sepse shënojnë kamion dubël kabin me tri dyer e jo kamion për borë. Andaj në këtë kontekst, ekspertja shqyrtuese konsideron se GOE në fjalë nuk e ka plotësuar në tërësi kriterin e kapacitetin teknik duke qenë se pajisja e paraqitur MAN L 2000 me tabela të regjistrimit 05-647-GF nuk është në pajtueshmëri me kërkesën e specifikuar në kërkesën nr. 4 të nenit 9.1&9.2 të FTD-së në të cilën është përcaktuar të jetë “automjet për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pflug dhe krypore) 3-7.5 ton me peshë totale” i cili automjet është i bashkëngjitur edhe për LOT 3, si e tillë atëherë nuk plotëson kërkesën edhe për LOT 3.

Gjithashtu, ekspertja shqyrtuese e ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor të ankuesit ku theksohet se AK i ka krijuar favore GOE në fjalë duke qenë se i njëjti ka paraqitur pajisje dhe makineri me regjistrim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, respektivisht të Tetovës, ashtu që AK e kishte injoruar kërkesën e vet duke mos realizuar vizitë në teren për verifikimin e makinerisë të prezantuar në listën e pajisjeve të GOE. Në lidhje me këto pajisje dhe makineri, OE ankues pretendon se të njëjtat nuk mund të jenë në dispozicion të realizimit të kontratës në relacion me kohëzgjatjen e punëve të parashikuara për realizimin e projektit, sepse sipas Ligjit për Automjetet, qarkullimi i mjeteve të huaja në Republikën e Kosovës është i kufizuar pasi që ato mund të qarkullojnë vetëm deri në gjashtë (6) muaj nëse janë të regjistruara. Ekspertja Shqyrtuese pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, lidhur me automjetet për regjistrim/targa ne vendin e huaj, konsideroj se AK gjate procesit te vlerësimit ne mënyrë që të respektoj parimet e trajtimi të barabartë dhe mos diskriminim duhet të ketë parasysh rrethanat dhe specifikat e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit, duke qenë se sipas kodit nr.03/L-109 Doganor dhe i Akcizave ne Kosove dhe

Ligjit nr.05/L-132 për automjetet, mjetet me regjistrim/targa në vendin e huaj e kanë të kufizuar qëndrimin apo pjesëmarrjen në trafikun rrugor në Kosovë, jo më gjatë se tre muaj respektivisht 6 muaj nga data e hyrjes në Kosovë. Andaj si e tillë pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar, sepse AK-ja nuk ka zhvilluar vizite në teren për verifikimin e pajisjeve me targa të huaja të prezantuara në listën e GOE të rekomanduar për kontratë, në këtë kontest AK-ja nuk ka asnjë fakt të verifikueshëm se a kanë qenë gjatë vlerësimit pajisjet e prezantuara në listën e pajisjeve të GOE në vend punishten e vet, brenda në Kosovë.

Përgjigje në pretendimin e katërt të OE ankues kundër GOE të rekomanduarit: OE ankues pretendon që GOE të lartcekur ka paraqitur tender jonormalisht të ulët në kuptim të paragrafit 2 të nenit 61 të LPP-së nëpërmjet çmimeve manipulative që në mënyrë substanciale janë nën nivelin e çmimeve reale të tregut, përfshirë edhe krahasimin e saj në kontekstin e vlerës së parashikuar të kontratës në shumën prej 194,000.00€, vlerë e cila është përcaktuar pas hulumtimit dhe krahasimit të çmimeve të tregut, strukturës së tregut dhe tendencave të kostos së mundshme të prokurimit përkatës, çmimeve të kontratave paraprahe nga kontratat e njëjta nga ana e AK-së sipas nenit 13 të RRPP Nr. 001/2022 dhe Udhëzuesit për Analizën e Tregut i nxjerrë nga KRPP dhe publikuar me datë 12.04.2023 në ueb faqen e KRPP-së. Ashtu që sipas OE ankues oferta e GOE me çmimin prej 138,201.91€ është për 28% më e lire se vlera e parashikuar e kontratës, gjersa të gjitha ofertat tjera të përgjegjshme janë të përafërta me vlerën e parashikuar. Prandaj si dëshmi ka paraqitur një tabelë ku pasqyrohet një analizë financiare krahasimore me çmime të ndryshme lidhur me elementet e tenderit me përshkrim të njëjtë të punëve për të cilat pretendon se janë me çmime jo-normalisht të ulët.

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi si dhe duke pasur parasysh vlerën e parashikuar të kontratës, krahasimin e çmimeve me çmimet e kontratave paraprahe që ekzistojnë për punët e njëjta, konsideron se pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar, për faktin se i njëjti ka ofertuar me çmime të ndryshme për pozicione të njëjta nëpër LOTE të tjera, gjithashtu marrë parasysh kontratën paraprahe me të njëjtin autoritet kontraktues, rezulton se AK konform nenit 61 të LPP-së, përkatësisht nenit 41.4 dhe 41.5 të RRPP-së nr.001/2022, AK duhet të kërkoj sqarime inter partes lidhur me pozicionet, nëse vërehet se pozicionet kanë çmime jo-normalisht të ulëta.

Gjithashtu, OE ankues pretendon se oferta e GOE ka çmime jo-normalisht të ulëta në pozicionin nr. 1 që nuk korrespondojnë me çmimet e tregut dhe në kontekstin krahasues as me çmimet e kontratave paraprahe me objekt të njëjtë të punëve dhe ofertues të njëjtë. (pa nevojë që të gjitha ato sërish të përshkruhen dhe të komentohen). Sepse, në projektin aktual lidhur me këtë pozicion, për njësinë për 1 dam², GOE në fjalë ka ofertuar me çmim për 1 dam² prej 0.05€, dhe totalin e çmimit me TVSH në lartësinë prej 9,246.60€.

Kurse në kontekstin krahasues me kontratën paraprahe nr. 616-23-7539-2-1-1/CI322 për projektin me titull “Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanal. Atmosferik dhe ujëmbledhësit)” të inicuar nga AK- Komuna e Prishtinës, bazuar në ofertën e GOE “VJV Group dhe OE Rahovica Commerce, për pozicionin e njëjtë, njësinë për 1 dam², ka ofertuar me çmim për 1 dam² prej 0.35€, dhe totalin e çmimit me TVSH në lartësinë prej 252,569.35€.

Andaj përse i përket këtij pretendimi, duke u bazuar në analizën e fakteve dhe provave që gjenden në shkresat e kësaj lënde, ekspertja shqyrtuese vlerëson se, AK duhet që të respektoj dispozitat ligjore të LPP-së dhe RRPP-së përkatësisht nenin 41.4 dhe 41.5 lidhur me çmimet jo-normalisht të ulëta, për faktin se dhënia e kontratës një tenderuesi me çmime jo-normalisht të ulët ka ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës, rrjedhimisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës. Po ashtu, OE ankues pretendon se oferta financiare e GOE është jo-normalisht e ulët edhe në kuptimin e nenit 17 paragrafi 32 të RRPP Nr. 001/2022 me arsyetimin se çmimi i ofruar nga GOE nuk i mbulon pagat minimale të punonjësve që do të përfshihen në ekzekutimin e kontratës. Lidhur me këtë si dëshmi e ka paraqitur një dokument në formë tabelore ku pasqyrohet një analizë financiare për llogaritjen e kostos së pagave minimale të 25 punëtorëve dhe një inxhinier të ndërtimitarisë si menaxher i projektit përfshirë edhe

kontributet tatimore. Në kontekst të kësaj situate, OE ankues pretendon se AK me qëllim të krijimit të favoreve për interesat e GOE i ka hequr nga dosja e tenderit të verzioni fillestar dhe verzioni i korrigjuar i dt. 29.11.2023 kërkesën për numrin minimal të punëtorëve prej 25 sosh të domosdoshëm për realizimin e kontratës për secilin lot veç e veç në kundërshtim me paragrafin 4.4 të nenit 69 të LPP.

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, konsideron se pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar. Për sa i përket pretendimit lidhur me heqjen e kërkesës lidhur me përcaktimin e numrin minimal të punëtorëve prej 25 sosh të domosdoshëm për realizimin e kontratës për secilin lot (nga lot 1 deri lot 9), ekspertja shqyrtuese vlerëson se, në kontekstin ligjor nuk mund të vendoset një kërkesë e cila nuk e përcakton kriterin minimal të kapaciteteve të OE, në rastin konkret lidhur me kriterin minimal të kapaciteteve minimale stafit të nevojshëm në funksion të përmbushjes së kontratës. Ngase ashtu siç i ka përcaktuar kapacitetet minimale ekonomike dhe financiare, kapacitetet teknike për mekanizmin dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e projektit, në këtë linjë do të duhej të përcaktoheshin edhe kapacitetet profesionale lidhur me stafin e domosdoshëm, respektivisht të mos largohej kërkesa paraprake për stafin profesional e vendosur nga vet AK-ja e cila është domosdoshmërisht obligative dhe drejtpërdrejt e lidhur me kërkesën e kapacitetin teknik në funksion të përmbushjes së kontratës. Megjithatë ekspertja shqyrtuese vlerëson se OE ankues si palë e interesuar është dashur të kërkojë nga ana e AK-së gjatë fazës së sqarimit të tenderëve të ndërmarrë veprime korrigjuese për të rregulluar dosjen në pajtueshmëri me këtë ligj, apo në të kundërtën t'a ndjek procedurën e ankimimit siç përcaktohet me nenin 108/A të LPP-ës. Kurse për sa i përket pretendimit dhe analizës financiare që është prezantuar si dëshmi për argumentimin e këtij pretendimi se tenderi i GOE përbën tender jo-normalisht të ulët në kuptim të nenit 17 paragrafi 32 i RRPP Nr. 001/2022, me arsyetimin se oferta totale e këtij të fundit nuk i mbulon pagat minimale të stafit që do të përfshihen në ekzekutimin e kontratës, ekspertja shqyrtuese sqaron se në kontekstin e vlerësimit të përgjithshëm të gjendjes faktike nga shkresat e lëndës, një analizë e tillë ku janë përfshirë mbulimi i pagave minimale 250.00€ dhe taksat që do tu paguhen të punësuarve të përfshirë në realizimin e këtij projekti pa llogaritur kostot tjera, duhet të mirët në konsideratë si e bazuar. Këtë mendim ekspertja e mbështet duke u bazuar në kontekstin krahasues të vlerësimit të të gjitha provave, fakteve, rrethanave dhe shkresave në dispozicion të kësaj lende nga të cilat vërtetohet situata faktike që oferta e GOE mund të konsiderohet dhe trajtohet si ofertë jo-normalisht e ulët. Sipas sqarimeve më lartë, OE ankues në ankesë ka atakuar GOE të rekomanduarin Via Egnatia Sh.P.K.&VJV Group L.L.C.& Rahovica Commerce Sh.P.K. &Infrastruktura Sh.P.K., krahas situatë së lartë cekur, ekspertja shqyrtuese vlerëson se marrëveshja me numër protokolli 21709 e datës 30.01.2024 e lidhur me mes ATK dhe anëtarit të GOE "Rahovica Commerce SHPL" për pagesë të borxheve tatimore me këste në shumën prej 149.956.33 euro është në kundërshtim me kërkesën 1/ dëshmia 2 të nenit 6.4 të FTD-se dhe me kundërshtim me dispozitën e nenit 65 par.4.8 të LPP-se. Kjo për faktin se në kërkesën e lartë cekur të DT-së nuk është parashikuar një mundësi tjetër shtese. Përveç tjerash ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo marrëveshje e dorëzuar në AK pas periudhës së publikimit të njoftimit për kontratë të dt.19.11.2023 edhe pas periudhës së hapjes së ofertave me dt.22.01.2024, dhe si e tillë edhe nëse hipotetikisht të ishte pjesë e kërkesës në dosje të tenderit, e njëjta është dorëzuar në kundërshtim me periudhën kohore të përcaktuar me nenin 65 par.5 të LPP-së. Andaj OE i rekomanduar eliminohet si i papërgjegjshëm, gjithashtu i njëjti nuk plotëson edhe pajisjet konform kërkesës në ankesë 7- LOT 3. Kurse, operatori ekonomik i radhitur para tij RSM Company Shpk, sipas sqarimeve më lartë, i njëjti nuk plotëson pajisjet konform kërkesës në ankesë 7-LOT 3, si e tillë ekspertja shqyrtuese konsideron se nuk e plotëson kriterin për LOT 3, i cili rezulton si i papërgjegjshëm.

3.3-Vleresimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 234/24 të operatorit ekonomik "AVAG Group" SH.P.K

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22. 03. 2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 234/24 ndërsa me datë 08. 04. 2024 u dorëzua raporti ekspertizës të ekspertës shqyrtuese.

Lidhur me ankesën nr. 234/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda LOT 11 të kthehet në rivlerësim”.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar lidhur me mendimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese, ndërsa operatori ekonomik është deklaruar se pajtohet.

Sqarim hyrës: Aktiviteti i prokurimit me titull “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve deblllokimi i kanalizimit atmosferik “ me numër të prokurimit :616-23-13231-2-1-1, iniciuar nga AK- Komuna e Prishtinës.

Publikimi i njoftimit për kontratë është bërë me datë 24.11.2023, procedurë e hapur, kontratë për shërbime, ku aktiviteti është i ndarë në 14 Lote, hapja e ofertave është zhvilluar me datë 22.01.2024, dhe vendimi B58 i AK-së u publikua me datë 23.02.2024. OE ankuesi ka parashtruar ankesë për pjesën LOT kundër vendimit të AK-së.

OE ankues përmes ankesës të parashtruar nga avokati sipas autorizimit, pretendon që AK gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e procedurës së vlerësimit, dhe ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabueshëm të dispozitave të drejtës materiale LPP-së. Sepse, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në përputhje me nenin 59, 60, 7 dhe dispozitave tjera relevante të LPP-së duke i shkaktuar pasoja OE ankues, për faktin se AK e ka rekomanduar me dhënien e kontratës për LOT 11 GOE “Via Egnatia Sh.P.K. & VJV Group L.L.C.& Rahovica Commerce Sh.P.K. & Infrastruktura Sh.P.K. Dega Në Kosovë” i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat kualifikuese të dosjes së tenderit dhe për më tepër pretendohet se ka paraqitur tender jo-normalisht të ulët. Gjithashtu OE ankues pretendon se edhe tenderi i paraqitur nga GOE tjetër i radhitur para tij “Alko Impex & General Construction & Company Murseli & Ntsh Krasniqi” është i papërgjegjshëm me arsyetimin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat kualifikuese të dosjes së tenderit dhe ka paraqitur tender jo-normalisht të ulët. Lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të OE ankues, të deponuar në AK më 28.02.2024, AK përmes vendimit të saj të datës 07.03.2024 kishte vendosur që t’u refuzoj si të pabazuar kërkesën e OE ankues dhe e ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 23.02.2024. Kundër këtij vendimi dhe veprimeve të AK-së që lidhen me të njëjtin, OE ankues ka paraqitur një mori pretendimesh ankimore për shkelje esenciale procedurale dhe materiale.

Përgjigje në pretendimin lidhur me veprimet dhe pikën 7 të vendimin të AK për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim: Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, bazuar në platformën E-prokurim, nga provat dhe shkresat e lëndës vërtetohet se OE ankues “AVAG Group” Sh.p.k. me datën 28.02.2024 ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK – Komunës së Prishtinës kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 23.02.2024 lidhur me LOT 11. Përderisa për aktivitetin në fjalë AK nuk ka pezulluar aktivitetin e prokurimit konform nenit 108/A paragrafi 2 i LPP-së, e cila e obligon autoritetin kontraktues që ta pezulloj aktivitetin e prokurimit në momentin e dorëzimit të një kërkesë për rishqyrtim. Gjithashtu AK kërkesën nuk ka shqyrtuar brenda afatit 3 ditë, në anën tjetër nuk ka njoftuar ankuesin për zgjatje të afatit shtesë, dhe rrjedhimisht nuk ka shqyrtuar kërkesën as brenda afatit shtesë, bazuar në e-prokurim, vendimi është publikuar në ditën e tetë konkretisht me datë 07.03.2023, andaj AK ka shkelur nenin 108/A paragrafi 6 i LPP-së. Tutje, gjithashtu edhe arsyeja e refuzimit të kërkesë për rishqyrtim është në kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 12, e cila përcakton se, kundërshtimet dhe vendimet e miratuara duhet të jenë të arsyetuara, si e tillë, AK nuk ka argumentuar dhe arsyetuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, andaj sipas sqarimeve më lartë ekspertja shqyrtuese pretendimin e OE ankues e konsideron të bazuar.

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues: Ekspertja Shqyrtuese pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqaron se, AK në letrën standarde për të eliminuarit B42, ka specifikuar se OE në fjalë i plotëson kriteret vetëm për LOT 11 ndërsa për LOT 10 nuk i plotëson për shkak të makinerive.

Tutje, OE në fjalë në ofertë për LOT 11 ka të bashkangjitur listën e pajisjeve, në të cilën janë të paraqitura 2 kamion me libreza të Kosovës me regjistrim valid, mirëpo makineria me targa AA 014 ST nga Shqipëria, konsideroj se duhet të sqarohet nga AK konform ligjit për automjete dhe leje të qarkullimit, për faktin se AK në DT ka përcaktuar se “Kamion për pastrimin e borës me mekanizëm komplet (pflug dhe krypore) ≥ 8 tonë me peshë totale. Vërejtje: Kamion gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë me librezë dhe me regjistrim valid. “si e tillë, meqenëse kërkohet validiteti i automjeteve, atëherë kërkohet edhe leja e qarkullimit për automjetet të cilat nuk janë me pronësi të Kosovës.

Si rrjedhojë, lidhur me automjetet për regjistrim/targa ne vendin e huaj, konsideroj se AK gjate procesit te vlerësimit ne mënyrë që të respektoj parimet e trajtimi të barabartë dhe mos diskriminim duhet të ketë parasysh rrethanat dhe specifikat e punëve të parapara në ketë aktivitet të prokurimit, duke qenë se sipas kodit nr.03/L-109 Doganor dhe i Akcizave ne Kosove dhe Ligjit nr.05/L-132 për automjetet, mjetet me regjistrim/targa ne vendin e huaj e kanë të kufizuar qëndrimin apo pjesëmarrjen në trafikun rrugor në Kosovë, jo më gjatë se tre muaj respektivisht 6 muaj nga data e hyrjes në Kosove. Andaj si e tillë pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar, sepse AK-ja nuk ka zhvilluar vizite në teren për verifikimin e pajisjeve me targa të huaja të prezantuara në listën e GOE të rekomanduar për kontratë, në këtë kontest AK-ja nuk ka asnjë fakt të verifikueshëm se a kanë qenë gjatë vlerësimit pajisjet e prezantuara në listën e pajisjeve te GOE në vend punishten e vet, brenda ne Kosove.

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues: Lidhur me këtë pozicion GOE në fjalë për njësinë për 1 dam², ka ofertuar me çmim për 1 dam² prej 0.09€, dhe totalin e çmimit me TVSH në lartësinë prej 761.82€. Sipas ankuesit çmimet reale dhe mesatare sipas strukturës së tregut për realizimin e këtij pozicioni ku përfshihen të gjitha shpenzimet për punët/shërbimet, janë me çmim mesatar të tregut nga 0.20 deri 0.65€.

Lidhur me këtë pozicion GOE në fjalë për njësinë për 1m³, ka ofertuar me çmim prej 0.10€, dhe totalin e çmimit me TVSH në lartësinë prej 3,805.60€. Sipas ankuesit çmimet reale dhe mesatare sipas strukturës së tregut për realizimin e këtij pozicioni ku përfshihen të gjitha shpenzimet për punët/shërbimet, janë me çmim mesatar të tregut nga 0.30 deri 0.0€ në m³

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi si dhe duke pasur në konsideratë, krahasuar çmimin e ofruar për LOT 10 dhe 11 konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar. Kjo për faktin se GOE për të njëjtin pozicion për LOT 10 ka ofruar çmimin 0.50 cent për metër katror ndërsa për LOT 11 ka ofruar çmimin 0.10 cent për metër katror. Andaj duke qenë se ndalohej përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik, oferta e GOE i plotëson kushtet për t'u trajtuar sipas procedurës inter partes si tender jo-normalisht i ulët në bazë të nenit 61 paragrafi 2 të LPP-së, dhe neni 41.4 dhe 41.5 i RRPP-së nr.001/2022.

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues: Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të bashkangjitur nga OE i rekomanduar në platformën e-prokurimi, ekspertja shqyrtuese ka gjetur se anëtari i GOE i rekomanduar me kontratë “Rahovica Commerce Shpk” ka paraqitur vërtetimin tatimor nr.1001137814 të dt.18.01.2024 në kundërshtim thelbësor me kërkesën 1/dëshmia 2 të nenit 6.4 të FTD-së të dosjes së tenderit, ku shprehimisht për t'a plotësuar këtë kërkesë është kërkuar që operatorët ekonomik duhet të paraqesin “Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit” Ky fakt argumentohet me vërtetimin tatimor të paraqitur nga GOE i rekomanduar me kontrate, OE “Rahovica Commerce SHPK” ka borxhe tatimore

te pa shlyera në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje për shlyerje të borxheve të mbetura. Pra, situata e cekur e vërteton se anëtari i GOE i rekomanduar për kontratë është në vonesë për pagimin e borxheve deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit. Lidhur me këtë çështje ekspertja shqyrtuese sqaron se, në kërkesën 1/dëshmia 2 të nenit 6.4 të FDT-se nuk është parashikuar një mundësi tjetër e ofrimit të vërtetimit tatimor me borxhe, marrëveshja për shlyerjen e borxheve apo që kjo situatë të dëshmohet përmes një dokumenti tjetër shtese apo alternative si psh. Marrëveshje për shlyerje të borxheve etj. Në këtë kontekst ekspertja shqyrtuese konsideron se AK gjatë procesit të vlerësimit nuk ka pasur të drejtë të aplikoj kritere me karakter favorizues në dobi dhe interes të GOE i cili nuk ka përcaktuar në dosje të tenderit. Ngase ky veprim është në kundërshtim me nenin 59 lidhur me nenin 7 të LPP-se.

Përveç kësaj ekspertja shqyrtuese sqaron se, vërtetimi Tatimor nr. 100137814 i dt. 18.01.2024 i lëshuar për anëtarin e GOE të rekomanduar është pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë në e-prokurim që është 24.11.2023. Andaj si e tillë është në kundërshtim me periudhën e përcaktuar në nenin 65 par. 5 të LPP-së i cili përcakton:” Periudhat kohore të përcaktuara në këtë Nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin ftesës për pjesëmarrje ose tenderim”

Krahas situatës së lartë cekur, ekspertja shqyrtuese vlerëson se është marrëveshja me numër protokollit 21709 e datës 30.01.2024 e lidhur në mes ATK dhe anëtarit të GOE “Rahovica Commerce SHPK” për pagesë të borxheve tatimore me këste në shumën prej 149.956.33 euro është në kundërshtim me kërkesën 1/ dëshmia 2 të nenit 6.4 të FTD-se dhe me kundërshtim me dispozitën e nenit 65 par.4.8 të LPP-se. Kjo për faktin se në kërkesën e lartë cekur të DT-së nuk është parashikuar një mundësi tjetër shtese. Përveç tjerash ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo marrëveshje e dorëzuar në AK pas periudhës së publikimit të njoftimit për kontratë të dt.24.11.2023 edhe pas periudhës së hapjes së ofertave me dt.22.01.2024 dhe si e tillë edhe nëse hipotetishtë të ishte pjesë e kërkesës në dosje të tenderit, e njëjta është dorëzuar në kundërshtim me periudhën kohore të përcaktuar me nenin 65 par.5 të LPP-së.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 65 paragrafi 5 i LPP-së, si dhe kërkesat në dosje të tenderit, interpretimi i KRPP-së nr.6 i datës 22.11.2022, vendimi i panelit shqyrtues 2023/0386 i datës 21.07.2023, nënkupton se OE nuk ka sjellë të gjitha dëshmitë e pranueshmërisë konform nenit 65 par.5, marrëveshja me nr. 21709 e datës 30.01.2024 për shlyerje të borxheve është e themeluar pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë, përkatësisht edhe pas datës së dorëzimit të ofertave, dhe si e tillë sipas sqarimeve, ekspertja shqyrtuese konstaton se GOE i rekomanduar për kontratë LOT 3 është i papërgjegjshëm.

Kurse, sa i përket pretendimit në lidhje me kërkesën që GOE t’i konfiskohet sigurimi i tenderit dhe inicohet procedura për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së, ekspertja shqyrtuese sqaron se për këtë çështje nuk ka kompetenca të përgjigjet duke qenë se kjo është në diskrecion të panelit shqyrtues.

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues: Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, konkretisht listës të pajisjeve/mekanizmit të obligueshëm sipas Aneksit 7 që është paraqitur nga GOE në fjalë, konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar, për faktin se GOE në dosjen për LOT 3 e ka bashkëngjitur vetëm Aneksin 7 (Pajisjet dhe Mekanizmi i Obligueshëm) i cili përmban rubrikat për të dhënat vetëm për llojin e pajisjeve të kërkuara dhe sasinë e kërkuar (copë). Por nuk e ka paraqitur në listën e pajisjeve llojin e makinerisë, nr e targave, ose çfarëdo informate e cila nënkupton se cilat pajisje i posedon në ofertë, për faktin se, gjatë vlerësimit të ofertave, në rast se duhet të kërkohet sqarime, atëherë, nëse në listë nuk ka të specifikuar llojin, nr etj, atëherë nuk mund të sqarohet, sepse i bie ndryshim material. Si e tillë lista e pajisjeve duhet të përmbajë informatat e nevojshme, në mënyrë që në rast sqarimi mund të lejohet. Shikuar objektivisht, kjo situatë vërtetohet nga faktet e lartcekura duke qenë se GOE nuk ka paraqitur listën e pajisjeve apo mekanizmit të obligueshëm sipas nenit 69 paragrafi 4 në të cilin thuhet qartë se të dhënat lidhur me aftësinë teknike të OE mund të parashtrihen përmes një ose më shumë mjeteve sipas llojit, sasisë në vijim: nën paragrafi 5: raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve.

Përgjigje në pretendimin e tretë të OE ankues: Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të bashkangjitura në e-prokurim, krahasuar me pretendimet ankimore të parashtruara në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, si rrjedhojë, konform RRPP-së neni 64.2- Paraqitja e ankesës dhe afatet kohore për dorëzimin e një ankese në OSHP, ky pretendim ankimor i ngritur në ankesë, nuk mund të shqyrtohet për faktin se nuk ka qenë i parashtruar pranë AK-së.

Përgjigje në pretendimin e katërt të OE ankues: Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi si dhe duke pasur parasysh vlerën e parashikuar të kontratës, krahasimin e çmimeve me çmimet e kontratave paraprake që ekzistojnë për punët e njëjta, konsideron se pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar, për faktin se konform nenit 61 të LPP-së, përkatësisht nenit 41.4 dhe 41.5 të RRPP-së nr.001/2022, AK duhet të kërkoj sqarime inter partes lidhur me pozicionet.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues pretendon se oferta e GOE ka çmime jo-normalisht të ulëta në pozicionin nr. 5 që nuk korrespondojnë me çmimet e tregut dhe në kontekstin krahasues nuk korrespondojnë por janë diametralisht të kundërta me çmimet që janë paparaqitur për të njëjtin aktivitet por në lote tjera (lot 9,10,12) dhe nga ana tjetër nuk korrespondojnë as me çmimet e kontratave paraprake me objekt të njëjtë të punëve dhe ofertues të njëjtë. (pa nevojë që të gjitha ato sërish të përshkruhen dhe të komentohen).

Sepse, në LOT 11 lidhur me këtë pozicion, për njësinë për 1 m², GOE në fjalë ka ofertuar me çmim për 1 dam² prej 0.10€, dhe totalin e çmimit me TVSH në lartësinë prej 3,805.60€. Sipas ankuesit çmimet reale dhe mesatare sipas strukturës së tregut për realizimin e këtij pozicioni ku përfshihen të gjitha shpenzimet për punët/shërbimet, janë me çmim mesatar të tregut nga 0.30 deri 0.50€. Kurse në aspektin krahasues me ofertat që i ka paraqitur për të njëjtin aktivitet por në lotet tjera (lot 9,10,12), përkitazi me pozicionin e njëjtë nr. 5 janë paraqitur çmime krejtësisht dimaterialisht të kundërta të cilat janë të krahasueshme me çmimet mesatare të tregut. Për lot 9 ka ofertuar me çmim 1.00€; për lot 10 ka ofertuar me çmim 0.25€; për lot 11 ka ofertuar me çmim 0,25€ dhe për lot 12 ka ofertuar me çmim 0.35€.

Gjithashtu ky çmim është jo-normalisht i ulët dhe jo i besueshëm edhe në aspektin krahasues me ofertën e GOE “VJV Group dhe OE Rahovica Commerce lidhur me objektin e njëjtë të punës në kontratën paraprake me nr. 616-23-7539-2-1-1/CI322 për projektin me titull “Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanal. Atmosferik dhe ujëmbledhësit)” të inicuar nga AK- Komuna e Prishtinës. Sepse në rastin konkret për të njëjtin pozicion ka ofertuar me çmimet mesatare të tregut të cilat janë vënë në pah edhe nga OE ankues, ashtu që për njësinë për 1 m², GOE në fjalë ka ofertuar me çmim për 1 dam² prej 0.35€, dhe totalin e çmimit me TVSH në lartësinë prej 252,569.35€.

Andaj, për sa i përket këtij pretendimi, duke u bazuar në analizën e fakteve dhe provave që gjenden në shkresat e kësaj lënde, ekspertja shqyrtuese vlerëson se, AK duhet që të respektoj dispozitat ligjore të LPP-së dhe RRPP-së përkatësisht nenin 41.4 dhe 41.5 lidhur me çmimet jo-normalisht të ulëta, për faktin se dhënia e kontratës një tenderuesi me çmime jo-normalisht të ulët ka ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës, rrjedhimisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës.

Sipas sqarimeve më lartë, OE ankues në ankesë ka atakuar GOE të rekomanduarin Via Egnatia Sh.P.K.&VJV Group L.L.C.& Rahovica Commerce Sh.P.K. &Infrastruktura Sh.P.K., krahas situatë së lartë cekur, ekspertja shqyrtuese vlerëson se marrëveshja me numër protokoll 21709 e datës 30.01.2024 e lidhur me ATK dhe anëtarit të GOE “Rahovica Commerce SHPL” për pagesë të borxheve tatimore me këste në shumën prej 149.956.33 euro është në kundërshtim me kërkesën 1/ dëshmia 2 të nenit 6.4 të FTD-se dhe me kundërshtim me dispozitën e nenit 65 par.4.8 të LPP-se. Kjo për faktin se në kërkesën e lartë cekur të DT-së nuk është parashikuar një mundësi tjetër shtese. Përveç tjerash ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo marrëveshje e dorëzuar në AK pas periudhës së publikimit të njoftimit për kontratë të dt.24.11.2023 edhe pas periudhës së hapjes së ofertave me dt.22.01.2024, dhe si e tillë edhe nëse hipotetikisht të ishte pjesë e kërkesës në dosje të tenderit, e njëjta është dorëzuar në kundërshtim me

periudhën kohore te përcaktuar me nenin 65 par.5 te LPP-së. Andaj OE i rekomanduar eliminohet si i papërgjegjshëm.

Kurse, operatori ekonomik i radhitur para tij GOE “Alco Impex & General Construction & Company Murseli & Ntsh Krasniqi” Sh.p.k., sipas sqarimeve më lartë, i njëjti është kontestuese se nëse i plotëson pajisjet konform kërkesës në ankesë 7-LOT 11, për faktin se duhet të sqarohen dhe verifikohen nga ana e AK-së, sipas sqarimeve më lartë. Gjithashtu OE në fjalë sipas pretendimit të OE ankues ka ofertuar me çmime jo-normalisht të ulëta, dhe si e tillë konform nenit 61 paragrafi 2 të LPP-së, dhe neni 41.4 dhe 41.5 i RRPP-së nr.001/2022, duhet AK të kërkoj sqarime inter partes.

Rekomandim i ekspertit shqyrtues;

Si përfundim, sqarojmë se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë parashtruar tri ankesa pranë OSHP-së përkatësisht për pjesët LOT 2 lënda me nr.210/24, LOT 3 lënda me nr.233/24 dhe LOT 11 lënda me nr. 234/24. Të cilat ankesa janë shqyrtuar objektivisht në mënyrë individuale duke rezultuar në rekomandimin Rivlerësim, për faktin se sipas sqarimeve nëpër pretendimet ankimore, të njëjtat gjenden të bazuara, andaj si e tillë ekspertja shqyrtuese konsideron se pjesët LOT 2, LOT 3 dhe LOT 11 duhet të rivlerësohen konform dispozitave ligjore të LPP-së.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur. Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyruar për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se sipas të thënave më sipër raporti i ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues; “V.Z. Company” Sh.p.k me nr. 2024/0210, “EL-BAU” SH.P.K Sh.p.k me nr. 2024/0233 dhe “AVAG Group SH.P.K.” me nr.

2024/0234. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se; pretendimet ankimore të OE“V.Z. Company” Sh.p.k me nr. 2024/0210, janë vlerësuar si pjesërisht të bazuara për Lot-2. ; pretendimet ankimore të OE “EL-BAU” SH.P.K, me nr. 2024/0233, janë vlersuar si të bazuar për Lot-3; dhe pretendimet ankimore të OE “AVAG Group SH.P.K.” me nr. 2024/0234, janë vlersuar si të bazuar për Lot-11, me rekomandimin përfundimtar për kthimin ne rivlerësim te aktivitetit të prokurimit për Lot 2, Lot 3 dhe Lot 11, prokurimi me titull, “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve deblllokimi i kanalizimit atmosferik” me nr. të prokurimit: "616-23-13231-2-1-1" të iniciuar nga autoriteti kontraktues, Komuna e Prishtinës.

Bazuar në shkresat e lëndëve dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli shqyrtues lidhur me ankesën e OE,“V.Z. Company” Sh.p.k me nr. 2024/0210, e ka analizuar Raportin e ekspertit shqyrtues me numër 2024/210, te datës 08.04.2024, të hartuar me kërkesën Panelit për të shqyrtuar bazën ligjore të pretendimeve ankimore, të Operatori ekonomik “V.Z. Company” Sh.p.k dhe raporti/eksperti ka konstatuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë vlerësimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertes shqyrtuese. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik, “V.Z. Company” Sh.p.k duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Përfundimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar ,Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të Komunes se Prishtinës për Loti- 2, aktivitet i prokurimit me numër; "616-23-13231-2-1-1" dhe lënda per Lot-2 kthehet ne rivlerësim.

Paneli shqyrtues lidhur me ankesën e OE“EL-BAU” SH.P.K, me nr. 2024/0233, e ka analizuar Raportin e ekspertit shqyrtues me numër 2024/233, te datës 08.04.2024, të hartuar me kërkesën Panelit për të shqyrtuar bazën ligjore të pretendimeve ankimore, të Operatori ekonomik “EL-BAU” SH.P.K, dhe raporti/eksperti ka konstatuar se pretendimet ankimore janë të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë vlerësimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertes shqyrtuese. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik, “EL-BAU” SH.P.K , duhet të aprovohet si e bazuar. Përfundimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar ,Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të Komunes së Prishtinës për Loti-3, aktivitet i prokurimit me numër; "616-23-13231-2-1-1" dhe lënda per Lot-3 kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues lidhur me ankesën e “AVAG Group SH.P.K.” me nr. 2024/0234, e ka analizuar Raportin e ekspertit shqyrtues me numër 2024/234, te datës 08.04.2024, të hartuar me kërkesën Panelit për të shqyrtuar bazën ligjore të pretendimeve ankimore, të Operatori “AVAG Group SH.P.K.” dhe raporti/eksperti ka konstatuar se pretendimet ankimore janë të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë vlerësimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertes shqyrtuese. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të

zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik "AVAG Group SH.P.K.", duhet të aprovohet si e bazuar. Përfundimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të Komunes së Prishtinës për Loti -11, aktivitetin e prokurimit me numër; "616-23-13231-2-1-1" dhe lënda për Lot-11 kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorëve Ekonomik duhet të aprovohen si të bazuara. Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetin e prokurimit të kthehet në ri-vlerësim duke qenë se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve nuk ka vepruar sic është paraparë në nenin 59 të LPP-së.

AK gjatë procesit të rivlerësimit të veprave në përputhje me vlerësimet e bazuara të pretendimeve ankimore të OE ankues sipas raportit të ekspertit, dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Po ashtu Paneli shqyrtues udhëzon AK-në që gjatë procedurave të Ri-vlerësimit të ketë parasysh aplikimin e qartë të dispozitave të nenit 72 të LPP-së, i cili lejon sqarimet dhe plotësimin e dokumentacionit citojmë: "Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankesave të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatorët ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4, lidhur me par 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 në LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " V.Z. Company " Sh.p.k., EL-BAU SH.P.K., AVAG GROUP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: